



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

10.06.2014

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Pezullohet hapja e ofertave për Valën 60 dhe Shitjet nr. 26

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit, ashtu si kishte paralajmëruar kohë më parë, sot ka pranuar edhe ofertat për Ndërmarrjet e Reja në privatizim dhe për Asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim. Përderisa pranimi i ofertave u shoqërua vetëm me dhunë verbale nga një grup banorësh të njohur për AKP-në, fatkeqësisht hapja e ofertave u ndalua dhunshëm nga të njejtët me pretendime të paqëndrueshme dhe të pabazuara lidhur me një aset të vetëm, nga 65 tërësisht sa ishin ofruar për transformim.

Të brengosur për sigurinë e stafit, për sigurinë e ofertuesve të tjerë dhe për të parandaluar dëmtimin e konkurrencës së procesit, AKP vendosi të pezulloj procesin e hapjes së ofertave për të gjitha shitjet e parapara të mbahen sot. Ky vendim i morr në mungesë të kushteve për të përmbushur obligimin që rrjedh nga Rregullat e Tenderit, neni 10.1: Ofertat do të hapen nga komisioni për hapjen e ofertave, në mënyrë publike, brenda tri (3) orëve pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës; pastaj neni 10.2: Komisioni për hapjen e ofertave do të bëj identifikimin dhe shpalljen publike të të gjitha ofertave të dorëzuara, për blerjen e artikujve të tenderuar; neni 10.3: Komisioni për hapjen e ofertave do të bëj identifikimin dhe shpalljen publike të ofertës së dorëzuar me çmimin më të lartë, për blerjen e artikujve të tenderuar.

Ofertat e pranuar për Valën 60 dhe Shitjen e Aseteve përmes Likuidimit nr. 26, nën përcjellje të Policisë së Kosovës janë duke u mbajtur të bllokuara, ndërsa Agjencia do të ftoj secilin ofertues veç e veç dhe do t'ia kthej atyre ofertat.

Për vendimin e rradhës për përsëritjen e kësaj shitjeje Agjencia do të njoftoj me kohë të gjithë opinionin.

AKP dënon dhunën ndaj procesit të mandatuar nga Kuvendi i Kosovës, fton për qetësi dhe udhëzon që të gjitha pretendimet të trajtohen në Gjykatën Supreme.

AKP rikujton se është e përkushtuar për proces të hapur dhe konkurrues të ofertimit, duke e transmetuar të njejtin drejtpërdrejt përmes kamerave në internet.

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org